



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**KËSHILLI BASHKIAK BERAT**  
**Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale**

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda:** “**MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET PNUD DHE BASHKISË BERAT NË KUADËR TË PROJEKTIT “PROGRAMI RAJONAL PER DEMOKRACINE VENDORE NE BALLKANIN PERENDIMOR 3 (RELOAD3)”**”

**Analiza ligjore:** (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar , ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjin nr. 43/2016 “Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 775 datë 24.09.2010 “Për Administrimin e Financimeve të Huaja në Republikën e Shqipërisë” pika 24, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 10, datë 12.07.2024 “Për Regjistrimin, Përdorimin, Rakordimin, Raportimin dhe Publikimin e Fondeve të Financimeve të Huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare”, Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Bashkisë Berat me nr.5675 Prot., datë 06.10.2025, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 78, date 20.10.2025 Mbi miratimin e projektit “Programi Rajonal per Demokracine Vendore ne Ballkanin Perendimor 3 (ReLOaD3)”, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 101 datë 22.12.2025 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028”;

**Situata aktuale e funksionit**(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Bashkia Berat, në kuadër të bashkëpunimit me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD), është përfutuese dhe partnere në zbatimin e Programit Rajonal për Demokracinë Vendore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3) në Shqipëri. Ky program synon forcimin e demokracisë vendore përmes rritjes së bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve përmes mbështetjes së iniciativave komunitare.

Në kuadër të zbatimit të këtij programi, Bashkia Berat, bazuar në **Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 5675, datë 06.10.2025**, ka shprehur angazhimin e saj për të bashkëfinancuar projektet e organizatave të shoqërisë civile në masën **30% të vlerës së tyre**, angazhim i cili është miratuar më herët me **Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 78, datë 20.10.2025 “Mbi miratimin e projektit “Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (RELOAD3)”**

#### Situata financiare :

**Marrëveshja e Financimit ndërmjet PNUD dhe Bashkisë Berat**, e cila, përveç kontributit të mësipërm të bashkëfinancimit në masën 30%, parashikon gjithashtu detyrimin e Bashkisë Berat për të mbuluar edhe **Tarifën e Menaxhimit të Programit (GMS) në masën 5%**, në përputhje me përcaktimet e **Nenit II të Marrëveshjes së Financimit (bashkëlidhur Marrëveshja e Financimit)**.

Në total, Bashkia Berat do të organizojë tri thirrje publike:

Thirrja Nr. 1, për vitin 2026, me vlerë totale të projekteve 4,500,000 leke, ku kontributi i bashkisë është 1,350,000 lekë dhe tarifa e menaxhimit (GMS 5%) është 67,500 lekë, duke e çuar kontributin total të bashkisë në 1,417,500 lekë.

Thirrja Nr. 2, viti 2027, me vlerë totale të projekteve 4,500,000 leke, ku kontributi i bashkisë është 1,350,000 lekë dhe tarifa e menaxhimit (GMS 5%) është 67,500 lekë, duke e çuar kontributin total të bashkisë në 1,417,500 lekë.

Thirrja Nr. 3, për vitin 2028, me një vlerë totale prej 4,000,000 lekësh, e cila do të financohet plotësisht nga fondet e Bashkisë Berat.

Për rrjedhojë, kontributi total i Bashkisë Berat në kuadër të kësaj marrëveshjeje për Thirjen e Parë Publike për Organizatat e Shoqërisë Civile (viti 2026) arrin në vlerën **1,417,500 lekë**, i cili përfshin:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- **1,350,000 lekë** bashkëfinancim (30% e vlerës së projekteve të mbështetura);
- **67,500 lekë** tarifë menaxhimi (GMS 5%).

Ky kontribut do të likuidohet në një këst të vetëm, brenda datës **30 maj 2026**, në llogarinë e përcaktuar të PNUD-it në Marrëveshjen Financiare.

Konkretisht, fondi i bashkisë do të mbështesë këto iniciativa:

Nr.	Emri i organizatës	Titulli i projektit	Kohëzgjatja	Periudha e zbatimit	Vlera Totale e Projektit (Lekë)	Kontributi i Bashkisë (Lekë)	GMS (5 %) (Lekë)	Kontributi total i Bashkisë (Lekë)
1	Shoqata Neë Bridges	Qendra rinore multifunkionale Lapardha: Fuqizimi i të rinjve për angazhim në komunitet	8 muaj	14 Prill 2026 – 15 Dhjetor 2026	ALL 2,500,000	ALL 750,000	ALL 37,500	ALL 787,500
2	The youth of ura	Rijetëzimi i tregut të gjelbër në Berat	8 muaj	14 Prill 2026 – 15 Dhjetor 2026	ALL 2,000,000	ALL 600,000	ALL 30,000	ALL 630,000
	<b>Total</b>				<b>ALL 4,500,000</b>	<b>ALL 1,350,000</b>	<b>ALL 67,500</b>	<b>ALL 1,417,500</b>

### Drejtoria / Sektori përgjegjës

1. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Integritit Evropian dhe Projekteve si dhe Drejtoria Juridike.

### A është objekt i konsultimit publik:

Jo. Nuk është objekt konsultimi

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale**”, i mbledhur në datën 29/04/2026, shqyrtoi projekt vendimin “**MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET PNUD DHE BASHKISË BERAT NË KUADËR TË**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROJEKTIT “PROGRAMI RAJONAL PER DEMOKRACINE VENDORE  
NE BALLKANIN PERENDIMOR 3 (RELOAD3)”**

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

**VENDOSI**

2. Të miratojë marrëveshjen e financimit ndërmjet PNUD dhe Bashkisë Berat në kuadër të programit “RELOAD 3 (Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3)”, bashkëngjitur këtij projekt vendimi.

3. Bashkia Berat do të organizojë tri thirrje publike:

Thirrja Nr. 1, viti 2026, me vlerë totale të projekteve 4,500,000 leke, ku kontributi i bashkisë është 1,350,000 lekë dhe tarifa e menaxhimit (GMS 5%) është 67,500 lekë, duke e çuar kontributin total të bashkisë në 1,417,500 lekë.

Thirrja Nr. 2, viti 2027, me vlerë totale të projekteve 4,500,000 leke, ku kontributi i bashkisë është 1,350,000 lekë dhe tarifa e menaxhimit (GMS 5%) është 67,500 lekë, duke e çuar kontributin total të bashkisë në 1,417,500 lekë.

Thirrja Nr. 3, për vitin 2028, me një vlerë totale prej 4,000,000 lekësh, e cila do të financohet plotësisht nga fondet e Bashkisë Berat

4. Fondi i nevojshëm prej 1,417,500 lekë për bashkëfinancimin e Bashkisë Berat për vitin 2026 do të përballohet nga buxheti i vitit 2026, Fond për Bashkëfinancime në projekte me financim të huaj në fushën e shërbimeve publike, si më poshtë :

Shtesë :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Podukti	Llog.	Pershkrimi	Vlera Lekë
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				1,417,500
2102001		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			787,500



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2102001	05	AF102	V823AAB	604	Transferte tek PNUD per bashkefinancim te projektit "Programi Rajonal per Demokracine Vendore ne Ballkanin Perendimor 3 (RELOAD3)"	787,500
		AD102	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve			630,000
2102001	05	AD102	V422AAC	604	Transferte tek PNUD per bashkefinancim te projektit "Programi Rajonal per Demokracine Vendore ne Ballkanin Perendimor 3 (RELOAD3)"	630,000
<b>Total Shtesa</b>						<b>1,417,500</b>

në lekë

Pakësim :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Podukti	Llog.	Pershkrimi	Vlera Lekë
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				1,417,500
2102001		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			1,417,500
2102001	05	AB102	P626ACT	231	Fond per Bashkefinancime ne projekte me financim te huaj ne fushen e sherbimeve publike	1,417,500
<b>Total Pakësim</b>						<b>1,417,500</b>

**Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale**

**Krenar Suku- Kryetar i Komisionit**

**Anisa Veliu –N/Kryetar**

**Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit**

**Fatjon Elezi-Anëtar**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Rovena Cuku-Anëtar**

**Muharem Hoxha-Anëtar**

**Shyqyri Dura-Anëtar**

Datë 29 /04/2026